



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

V E N D I M
K.P.P. 190/2021

Komisioni i Prokurimit Publik, i përbërë nga:

Jonaid Myzyri	Kryetar
Vilma Zhupaj	Anëtar
Lindita Skeja	Anëtar
Merita Zeqaj	Anëtar

Në mbledhjen e datës 30.04.2021 shqyrtoi ankesën me:

Objekt: Modifikimi i dokumentave të procedurës së prokurimit “*Kërkesë për Propozim*” me nr. *REF-91332-03-26-2021*, me objekt “*Blerje Kancelarie*”, me fond limit 1,666,633 lekë pa TVSH, parashikuar për tu zhvilluar në datën 09.04.2021 nga autoriteti kontraktor, Bashkia Himarë.

Ankimues: “InfoSofft Office” SHPK
Autostrada Tiranë-Durrës, Km 8, Kashar, Tiranë

Autoriteti kontraktor: Bashkia Himarë
Spile-Himarë

Baza Ligjore: Ligji nr. 9643, datë 20.11.2006 “*Për Prokurimin Publik*”, i ndryshuar, neni 19/1 e vijues, Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 914, datë 29.12.2014 “*Për miratimin e rregullave të prokurimit publik*”, i ndryshuar, Vendimi i Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 596/2018, datë 12.09.2018 “*Për miratimin e rregullave “Për Organizimin dhe Funksonimin e Komisionit të Prokurimit Publik*”, Neni 4, i Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 500/2020 datë 5.11.2020 “*Rregullore për Marrjen e Masave*”

Organizative për Ushtrimin e Veprimtarisë së Institucionit të Komisionit të Prokurimit Publik gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID -19”

Komisioni i Prokurimit Publik, pasi dëgjoi relatorin e çështjes, shqyrtoi parashtrimet me shkrim e pretendimet e ankimuesit, dhe pasi diskutoi çështjen në tërësi,

V ë r e n:

I

Vlerësimi paraprak

I.1. Pas shqyrtimit paraprak të ankesave të mbështetur në dokumentacionin e dërguar nga operatori ekonomik ankimues, Komisioni i Prokurimit Publik, konstatoi se operatori ekonomik ka *prima facie* interes në këtë procedurë prokurimi dhe për këtë arsye legjitimohen për të paraqitur ankesë në lidhje me të, bazuar në pikën 1 të nenit 6 të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar;

I.2. Operatori ekonomik ka paraqitur fillimisht ankesë pranë autoritetit kontraktor, dhe më pas kanë paraqitur ankesë, pranë Komisionit të Prokurimit Publik, si organi më i lartë në fushën e prokurimeve, që shqyrton ankesat për procedurat e prokurimit, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik” i ndryshuar.

I.3. Operator ekonomik ka respektuar afatet ligjore të paraqitjes së ankesës pranë autoritetit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik. Në këto kushte Komisioni i Prokurimit Publik mori në shqyrtim në themel objektin e ankesës së operatorit ekonomik ankimues.

II

Rrethanat e çështjes

II.1. Në datën 29.03.2021 është publikuar në sistemin e prokurimeve elektronike, në faqen zyrtare të Agjencisë së Prokurimit Publik, procedura e prokurimit “Kërkesë për Propozim” me nr. REF-91332-03-26-2021, me objekt “Blerje Kancelarie”, me fond limit 1,666,633 lekë pa TVSH, parashikuar për tu zhvilluar në datën 22.04.2021 nga autoriteti kontraktor, Bashkia Himarë.

II.2. Në datën 02.04.2021, operatori ekonomik ankimues “InfoSofft Office” SHPK ka paraqitur ankesë pranë autoritetit kontraktor, duke kërkuar modifikimin e kriterëve të kualifikimit. Në ankesë pretendohet si më poshtë vijon: [...] Kompania "InfoSoft Office" SHPK ka shprehur

interes të marrë pjesë në tenderin me objekt "Blerje Kancelarie" që institucionit juaj shpalli në faqen e APP-së me datë 29.03.2021, dhe do të zhvillojë me datë 09.04.2021.

-Në kriteret e veçanta të kualifikimit keni kërkuar:

2.3.3 Në mënyrë që të krahasohet pajtueshmeria me specifikimet teknike dhe standardet e kërkuara, operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë katalogun/et ose fragmente të katalogut/eve dhe skedat teknike të prodhuesit/ve të mallrave objekt prokurimi të përkthyer në gjuhën shqipe, në të cilën tregohen dhe të specifikohen qartë mallrat që do të ofrohen. (Operatorët ekonomikë do të paraqesin katalog për të gjithë artikujt, ndërsa skeda teknike do të paraqitet vetëm për letrën).

Katalogu hartohet nga ne si OE ofertues, për të gjithë artikujt e kërkuar nga ju në këtë tender, dhe ne e hartojmë në gjuhën shqipe. Katalogu i hartuar nga ne përmban të gjitha karakteristikat teknike që ju keni kërkuar, detaje, të gjitha në gjuhën shqipe, prandaj nuk ka asgjë për të përkthyer.

Në të gjitha procedurat e prokurimit që kemi ofertuar në më shumë se 20 vjet përvojë, katalogët kërkojnë të hartohen nga ne si ofertues. Kështu veprohet edhe në tenderin e përqëndruar të zhvilluar nga Ministria e Brendshme, që është procedura më e madhe për kancelari dhe tonerë.

Referuar edhe nenit 46 të LPP që përcakton që AK duhet të hartojë kërkesa në përputhje me natyrën dhe përmasat e kontratës, kërkojmë që të pranoni katalogët të hartuar nga ne si ofertues, në gjuhën shqipe.

Lutemi korrigjoni këtë kërkesë dhe kërkoni që katalogët dhe skeda të jenë në gjuhën shqipe, ose të jenë të përkthyer dhe noterizuar nëse do të jenë në gjuhë të huaj.

Siç përcaktohet në nenin 1 dhe 2 të LPP, për të mos penguar ofertimin, kërkojmë ndryshim të këtij kriteri.

-Në kriteret e veçanta të kualifikimit keni kërkuar:

2.3.4.1 Operatori ekonomik në ditën dhe orën e hapjes së procedurës duhet të paraqitet pranë Autoritetit kontraktor me nga një mostër për çdo artikull të kërkuar në preventiv.

Ju keni kërkuar që OE ofertues të paraqesin katalogë për të gjithë artikujt për të krahasuar pajtueshmërinë me specifikimet teknike dhe standardet e kërkuara. Madje për letrën, që është i vetmi artikull me specifikime të detajuara, keni kërkuar paraqitjen e skedës teknike të prodhuesit, e cila është e vetmja mënyrë për verifikimin e specifikimeve të letrës. Nga vërejtja e mostrës ju nuk arrini të kuptoni nëse letra plotëson parametrat e kërkuar nga ju. Për sa i përket tonerëve, çdo informacion i nevojshëm është i shënuar në katalog.

Ndërsa artikujt e kancelarisë janë artikuj të zakonshëm për përdorim nëpër zyra, që çfarë mirë kuptohen nga katalogu.

Në këto kushte, kërkesa për të paraqitur edhe mostra është e ekzagjeruar, sepse edhe mostrat për të njëjtin qëllim kërkohen: për të verifikuar përmbushjen e specifikimeve teknike dhe standardeve të kërkuara.

Qëllimin e verifikimit të përmbushjes së specifikimeve teknike dhe standardeve të kërkuara e përmbush më së miri katalogu.

Për më tepër, shumë artikuj janë kërkuar në sasi shumë të vogla.

Lidhur me paraqitjen e mostrave KPP është shprehur në vendimin K.P.P. 122/2020:

kërkesa për “dorëzimin e mostrave për secilin artikull, është një kërkesë e ekzagjeruar dhe shkon përtej asaj se çfarë është e nevojshme për realizimin e synimit. Komisioni gjykon se, është e mjaftueshme që operatorët ekonomikë pjesëmarrës të paraqesin vetëm nga një ekzemplar (mostër) për produktet që do të prokurohen, me përdorueshmëri më të lartë për institucionin, me qëllim verifikimin nëse këto produkte plotësojnë kërkesat dhe specifikimet teknike të përcaktuara në dokumentet e tenderit.

Lutemi të hiqet kërkesa për mostra në zbatim të nenit 46 të LPP ku thuhet se kërkesat duhet të jenë në përpjesëtim me natyrën dhe përmasat e kontratës, ose së paku të kërkohen mostra vetëm për artikujt me përdorim më të madh dhe për tonerat e kërkuar sete të pranohet të paraqesim si moster vetëm njerin nga tonerat e setit, pasi të gjithë tonerat e një seti janë njelloj, ndryshojnë vetëm nga ngjyra.

-Në kriteret e veçanta të kualifikimit keni kërkuar:

Gjithashtu ju keni vendosur specifikime teknike fikse apo të kufizuara për letër A4, gjë që na pengon të ofertojmë me letër më cilësore, që ka specifikime teknike më të larta se ato të kërkuarat.

Në një situatë të ngjashme, pikerisht për specifikimet e letrës A4, KPP është shprehur në vendimin 249/2020, se AK duhet të përcaktojë minimumin e specifikimeve duke lejuar ofertim me specifikime më të larta, për të mundësuar pjesëmarrjen e sa më shumë OE: Në këto kushte, Komisioni i Prokurimit Publik gjykon se autoriteti kontraktor duhet të modifikojë dokumentet e tenderit për procedurën objekt ankimi duke hequr markën e letrës "Double A" dhe për parametrat fikse të përcaktojë minimumin e tyre.

Prandaj kërkojmë që të vendosni një minimum pra lëmueshmëria 2:80, bardhësia ~169%, dhe të lejoni ofertimin me cilësi edhe më të mirë.

-Në specifikimet teknike keni kërkuar:

Tonerët duhet të jenë origjinale, bashkëlidhur, me pullë sigurie të firmës prodhuese dhe me numrin serial të njëjtë të stampuar në paketim.

Jo të gjithë prodhuesit aplikojnë vendosjen e numrit serial, dhe ka të tjerë që e aplikojnë vetëm në kuti por jo në toner.

Në këto raste ne nuk mund ti detyrojmë prodhuesit të vendosin numër serial sipas kërkesës tuaj (edhe në toner, edhe në paketim), sepse nuk kemi kompetenca dhe as mundësi të ndikojmë tek prodhuesit. Ata e përcaktojnë vetë se si i realizojnë produktet e tyre. Gjithashtu pullat e sigurisë të vendosura mbi paketime, janë një zgjedhje dhe një e drejtë që e ka vetëm prodhuesi. Në si tregtues të tonerëve nuk mund të detyrojmë prodhuesit të vendosin pulla në ambalazhet e tyre. Prandaj kjo kërkesë del jashtë kompetencave tona, vendosja e pullave nëpër ambalazhe nuk është në dorën tonë. Ju nuk mund të vendosni një kërkesë apo të na vlerësoni për diçka që nuk është as kompetencë, as e drejtë e jona si OE.

Komisioni i Prokurimit Publik në vendimin 325/2020, arsyeton se AK nuk mund të hartojë të tilla kërkesa "pasi plotësimi i kërkesës së mësipërme nuk varet nga vullneti i operatorëve ekonomikë pjesëmarrës për hartimin dhe dorëzimin e ofertave teknike":

Komisioni i Prokurimit Publik gjykon se kërkesa e mësipërme nuk është e përshtatshme për arritjen e synimit të autoritetit kontraktor, për verifikimin e përputhshmërisë së produkteve, kjo pasi plotësimi i kërkesës së mësipërme nuk varet nga vullneti i operatorëve ekonomikë pjesëmarrës për hartimin dhe dorëzimin e ofertave teknike në përputhje me kërkesën e autoritetit kontraktor...

Komisioni i Prokurimit Publik gjykon se kërkesa e mësipërme e autoritetit kontraktor nuk është proporcionale me objektin e procedurës së prokurimit, natyrën, përmasat e kontratës si edhe me qëllimin e kërkuar nga vetë autoriteti kontraktor.

Gjykuar sa më sipër, lutemi shtoni:

Tonerët duhet të jenë origjinale, bashkëlidhur, me pullë sigurie të firmës prodhuese (për rastet kur aplikohet nga prodhuesi) dhe me numrin serial të njëjtë të stampuar në paketim (për rastet kur aplikohet nga prodhuesi).

-Lidhur me specifikimet teknike, bazuar në nenin 23, lutemi na sqaroni:

Nr.	Përshkrimi	Specifikime teknike	Njësia	Sasia	Kërkesë për sqarim
6	Letër A4	a-Cilësi e parë me certifikatë Iso b-CIE Bardhësi: 169% dhe pa lustër c - Pesha e një fije 80 gr/m2 dhe një rizmë (500 fije x			

		<p>A4)</p> <p>d - Përmasat të jenë 210 x 297 mm dhe 297 x 420 mm</p> <p>e -Lëmueshmëria: 80-100 ml/min</p> <p>f-Multifunkionale – për fotokopje, printër, faks.</p> <p>-Ambalazhimi: Mbështjellje kundër lagështirës dhe kuti me kapacitet 5 risma</p> <p>-Të qëndrojnë e rrafshët pas printimit apo fotokopjimit</p> <p>- Të mos lëshojë pluhur letre pas printimit apo fotokopjimit</p> <p>-Të jetë e përshtatshme për printim në të dyja anët</p> <p>- Të plotësojë standardet që letra të mbahet për kohë të gjatë në arkivë</p>	kuti	150	Për këtë artikull kërkoni kuti me 5 risme?
7	Letër A3	<p>a-Cilësi e parë me certifikatë ISO</p> <p>b-CIE Bardhësi: 169% dhe pa lustër</p> <p>c - Pësja e një fije 80 gr/m² dhe një rizmë (500 fije x A4)</p> <p>d - Përmasat të jenë 210 x 297 mm dhe 297 x 420 mm</p> <p>e -Lëmueshmëria:80-100 ml/min</p> <p>f-Multifunkionale – për fotokopje, printer, faks.</p> <p>-Ambalazhimi: Mbështjellje kundër lagështirës dhe kuti me kapacitet 5 risma</p> <p>-Të qëndrojnë e rrafshët pas printimit apo fotokopjimit</p> <p>- Të mos lëshojë pluhur letre</p>	kuti	50	Për këtë artikull kërkoni kuti me 5 rismë?

		<p>pas printimit apo fotokopjimit</p> <p>-Të jetë e përshtatshme për printim në të dyja anët</p> <p>- Të plotësojë standardet që letra të mbahet për kohë të gjatë në arkivë.</p>			
1	Lexermark CS 310dn (4 ngjyra)		copë	2	Për këtë artikull kërkoni 2 sete me nga 4 ngjyra, apo vetëm 2 copë bojëra?
5	HP Color Laserjet CP 5225 PCL6 (4 ngjyra)		copë	3	Kërkoni tre sete secila me nga 4 ngjyra? Pra 12 copë në total?
10	HP Color Laserjet CP 5225 (4 ngjyra)		copë	8	Për këtë artikull kërkoni 8 sete me nga 4 ngjyra apo vetëm 8 copë bojëra?
11	Lexmark Color CS 410 dn (4 ngjyra)		copë	4	Për këtë artikull kërkoni 4 sete me nga 4 ngjyra apo vetëm 4 copë bojëra?
17	HP Color Laserjet 3800dn (4 ngjyra)		copë	3	Për këtë artikull kërkoni 3 sete me nga 3 ngjyra apo vetëm 3 copë bojëra?
19			copë	7	Na jepni modelin e plotë të pajisjes pasi

					Lexmark M317dn nuk është i plotë. Ekzistojnë modele MS 317, MX 317, CS 317, CX 317.
26	C3330i (4 ngjyra)		copë	2	Për këtë artikull kërkoni 4 sete me nga 4 ngjyra apo vetëm 4 copë bojëra.

Bazuar në nenin 63 të LPP po paraqesim këtë ankesë, duke kërkuar pezullim të procedurës deri në marrjen e një përgjigjeje..

II.3. Referuar dokumentacionit të administruar pranë KPP, në funksion të hetimit administrativ për procedurën e prokurimit objekt shqyrtimi, konstatohet se autoriteti kontraktor i ka kthyer përgjigje lidhur me ankesën operatorit ekonomik ankimes “InfoSoft Office” SHPK, me anë të shkresës me nr. 1274/1 prot., datë 09.04.2021 duke mos e pranuar atë dhe duke argumentuar se:

- *“Në bazë të ankesës tuaj me datë 02.04.2021 protokolluar në institucionin tonë me nr. 1274 prot, datë 07.04.2021, ju keni paraqitur ankesë në lidhje me disa kritere të vendosura nga njësia e hartimit të dokumenteve të tenderit për procedurën e prokurimit publik me objekt “Blerje kancelarie” me nr. REF-91332-03-26-2021, me fond limit 1,666,663 (një milion e gjashtëqind e gjashtëdhjetë mijë e gjashtëqind e tridhjetë e tre lekë) pa TVSH, për sa më sipër ju sqarojmë se në hartimin kritere është respektuar kuadri ligjor i Prokurimeve Publike. Në lidhje me kundërshtimin që keni paraqitur për kriterin 2.3.3 në mënyrë që të krahasohet pajtueshmëria me specifikimet teknike dhe standardet e kërkuara operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë katalogun/et ose fragmente të katalogut/ve dhe skedat teknike të prodhuesit/ve të mallrave objekt prokurimi të përkthyer në gjuhën shqipe, në të cilën tregohen dhe të specifikohen qartë mallrat që do të ofrohen. (Operatorët ekonomikë do të paraqesin katalog për të gjithë artikujt, ndërsa skeda teknike do të paraqitet vetëm për letrën. Kriteri 2.3.3 është një kriter shumë i rëndësishëm i vendosur nga njësia e hartimit të dokumenteve të tenderit për të garantuar cilësinë e materialeve dhe seriozitetin e operatorit ekonomik, ne kemi kërkuar katalog shoqërues për materialet, në qoftë se operatori juaj është prodhues i këtyre materialeve atëherë ju mund të depozitoni një katalog të hartuar nga ju në gjuhën*

shqipe, për artikujt që ju jeni distributor apo të furnizuar nga një subjekt tjetër, në rastin konkret nga një subjekt i huaj, ju duhet të depozitoni katalogun të përkthyer dhe të noterizuar.

- Në lidhje me kundërshtimin tuaj për pikën 2.3.4.1 Operatori ekonomik në ditën dhe orën e hapjes së procedurës duhet të paraqitet pranë autoritetit kontraktor me nga një mostër për çdo artikull të kërkuar në preventiv. Në bazë të VKM Nr.914, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik” nenin 27 pika 6 gërma a) thuhet; 6. Autoriteti kontraktor mund t’u kërkojë operatorëve ekonomikë të dorëzojnë dëshmi, që tregojnë se ata i plotësojnë kërkesat minimale, të përcaktuara në dokumentet e tenderit, si: a) mostra të mallit, kur e gjykon se kjo ka rëndësi për vlerësimin e ofertës teknike. Mostrat duhet të trajtohen si informacion konfidencial tregtar dhe duhet të jenë në kontroll të autoritetit kontraktor. Ato i kthehen ofertuesit, me kërkesën e tij, 30 (tridhjetë) ditë pas nënshkrimit të kontratës, me kusht që kontrata në fjalë të mos jetë objekt i shqyrtimit administrativ apo gjyqësor. Në rastin kur procedura e prokurimit anulohet, mostrat i kthehen ofertuesit, me kërkesën e tij, brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga data e marrjes së vendimit përfundimtar të anulimit; Në qoftë se operatori ekonomik kontraktues në të ardhmen nuk ka mundësi të plotësojë kriterin e mostrave, që është një artikull për çdo zë, si do mund të përmbushë kontratën në të ardhmen, pra kërkesa e mostrave është për dy arsye, e para për të vërtetuar cilësinë e materialeve dhe e dyta për të parë kapacitetin që ka operatori ekonomik për të përmbushur kontratën. Autoriteti kontraktor ka kërkuar nga një mostër për çdo artikull të kërkuar, për të verifikuar përmbushjen e specifikimeve teknike dhe përmbushjen e standarteve të kërkuara. Kërkimi i mostrave nga ana e autoritetit kontraktor është me qëllim për të vërtetuar që operatori ekonomik i ka këto mostra, që ka kapacitetet për të përmbushur kontratën që mos të gjendemi në situatën e një kontrate të lidhur dhe operatori ekonomik nuk ka mundësi ta përmbush.
- Në lidhje me kundërshtimin tuaj të tretë ku ju shprehni se ne kemi vendosur specifikime kufizuese për letrën, dhe ju po pengoheni për të ofertuar me një letër me cilës më të lartë, po ju sqarojmë se në vendosjen e këtyre specifikimeve janë mbajtur parasysh buxheti që ka në dispozicion autoriteti kontraktor si dhe pajisjet që ka në dispozicion autoriteti dhe në lidhje me sa më sipër mendojmë se këto specifikime janë më të përshtatshmet për ne.
- Në lidhje me kundërshtimin tuaj ku ne kemi kërkuar që “tonerat duhet të jenë origjinale, bashkëlidhur me pullë sigurie të firmës prodhuese dhe me numrin serial të njëjtë të stampuar në paketim’ ky kriter është shumë i rëndësishëm pasi është një element sigurie që lidh amballazhin me tonerin brenda, e bën më të vështirë për tu fallsifikuar apo tjetërsuar. Ju thoni që ky kriter të kërkohe vetëm nga prodhuesi dhe ne këtë kemi kërkuar për tonerat që prodhohen nga prodhuesi.
- Në lidhje me specifikimet teknike ju jeni të pa qartë në lidhje me termin “Kuti” po ju sqarojmë se me termin kuti ne kemi parasysh paketimin standard që përbëhet nga 5 risma.

- Në lidhje me paqartësinë tuaj për tonerat Lexmark CS310dn (4 ngjyra)x 2 copë, po ju sqarojmë se kërkojmë sete me nga katër ngjyra secila dhe në të gjitha rastet është kërkuar set me nga katër ngjyra.
- Në lidhje me zërin 5 ku kërkohet toner HP Color Laser Jet CP 5220 PCL6 (4 ngjyra) është e njëjtat gjë me HP Color Laser Jet CP 5225.”

II.4.Në datën 14.04.2021, operatori ekonomik ankimues “InfoSoft Office” SHPK ka paraqitur ankesë në Komisionin e Prokurimit Publik, me të njëjtin objekt drejtuar autoritetit kontraktor.

II.5. Nëpërmjet shkresës nr.1273/4 prot., datë 22.04.2021 protokolluar me tonën me nr.578/2 prot datë 26.04.2021 me objekt “Dërgohet informacion”, është depozituar në Komisionin e Prokurimit Publik informacioni i autoritetit kontraktor lidhur me procedurën e mësipërme të prokurimit.

III

Komisioni i Prokurimit Publik

pas shqyrtimit të ankesës, dokumentacionit bashkëngjitur, dokumenteve të dërguara nga autoriteti kontraktor,

Arsyeton

III.1 Lidhur me pretendimin e operatorit ekonomik “InfoSoft Office” SHPK për modifikimin e dokumenteve të procedurës së prokurimit me argumentin se:

[...]-Në kriteret e veçanta të kualifikimit është kërkuar:

2.3.3 Në mënyrë që të krahasohet pojtueshmëria me specifikimet teknike dhe standardet e kërkuara, operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë katalogun/ët ose fragmente të katalogut/ëve dhe skedat teknike të prodhuesit/ve të mallrave objekt prokurimi të përkthyer në gjuhën shqipe, në të cilën tregohen dhe të specifikohen qartë mallrat që do të ofrohen. (Operatorët ekonomikë do të paraqesin katalog për të gjithë artikujt, ndërsa skeda teknike do të paraqitet vetëm për letrën).

OE ofertues në shumicën e rasteve nuk janë prodhues.

Katalogu hartohet nga ne si OE ofertues, për të gjithë artikujt e kërkuar në këtë tender dhe ne e hartojmë në gjuhën shqipe. Katalogu i hartuar nga ne përmban të gjitha karakteristikat teknike të kërkuara, detaje, të gjitha në gjuhën shqipe, prandaj nuk ka asgjë për të përkthyer.

Në të gjitha procedurat e prokurimit që kemi ofertuar ne më shumë se 20 vjet përvojë, katalogët kërkohet të hartohen nga ne si ofertues. Kështu veprohet edhe në tenderin e përqendruar të zhvilluar nga Agjencia e Blerjeve të Përqendruara, që është procedura më e madhe për kancelari dhe tonerë.

Për më tepër jo të gjithë prodhuesit hartojnë katalogë. Ne jemi tregtues të këtyre produkteve dhe nuk mund të detyrojmë prodhuesit të hartojnë katalogë, kjo kërkesë nuk është në dorën tonë të realizohet, pasi i drejtohet një pale të tretë: prodhuesit.

Komisioni i Prokurimit Publik në vendimin 325/2020, arsyeton se AK nuk mund të hartojë të tilla kërkesa "pasi plotësimi i kërkesës së mësipërme nuk varet nga vullneti i operatorëve ekonomikë pjesëmarrës për hartimin dhe dorëzimin e ofertave teknike":

Komisioni i Prokurimit Publik gjykon se kërkesa e mësipërme nuk është e përshtatshme për arritjen e synimit të autoritetit kontraktor, për verifikimin e përputhshmërisë së produkteve, kjo pasi plotësimi i kërkesës së mësipërme nuk varet nga vullneti i operatorëve ekonomikë pjesëmarrës për hartimin dhe dorëzimin e ofertave teknike në përputhje me kërkesën e autoritetit kontraktor.

Komisioni i Prokurimit Publik gjykon se kërkesa e mësipërme e autoritetit kontraktor nuk është proporcionale me objektin e procedurës së prokurimit, natyrën, përmasat e kontratës si edhe me qëllimin e kërkuar nga vetë autoriteti kontraktor.

Referuar edhe nenit 46 të LPP që përcakton që AK duhet të hartojë kërkesa në përputhje me natyrën dhe përmasat e kontratës, kërkojmë që të pranohen katalogët e hartuar nga ne si ofertues, në gjuhën shqipe.

Lutemi të korrigohet kjo kërkesë dhe të kërkohet që katalogët dhe skeda të jenë në gjuhën shqipe, ose të jenë të përkthyer dhe noterizuar nëse do të jenë në gjuhë të huaj.

Siç përcaktohet në nenin 1 dhe 2 të LPP, për të mos penguar ofertimin, kërkojmë ndryshim të këtij kriteri. [...], Komisioni i Prokurimit Publik vëren se,

III.1.1. Në pikën 2.3.3 “Kapaciteti teknik” të dokumenteve të tenderit të procedurës së prokurimit objekt shqyrtimi, autoriteti kontraktor ka kërkuar si më poshtë vijon:

“2.3.3 Në mënyrë që të krahasohet pajtueshmëria me specifikimet teknike dhe standardet e kërkuara, operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë katalogun/et ose fragmente të katalogut/eve dhe skedat teknike të prodhuesit/ve të mallrave objekt prokurimi të përkthyer në gjuhën shqipe, në të cilën tregohen dhe të specifikohen qartë mallrat që do të ofrohen. (Operatorët ekonomikë do të paraqesin katalog për të gjithë artikujt, ndërsa skeda teknike do të paraqitet vetëm për letrën)”.

III.1.2. Në nenin 46, pika 1, gërma “b”, të ligjit nr.9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, parashikohet shprehimisht: *“Operatorët ekonomikë, për të marrë pjesë në procedurat e prokurimit, duhet të kualifikohen, pasi të kenë përmbushur të gjitha kriteret që autoriteti kontraktor i vlerëson të nevojshme, për sa kohë që ato janë në përpjesëtim me natyrën dhe përmasat e kontratës që do të prokurohen dhe jodiskriminuese. b) aftësia teknike: operatorët ekonomikë vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet*

organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, për të zbatuar kontratën, siç është përshkruar nga autoriteti kontraktor në njoftimin e objektit të kontratës;

Ndërsa në nenin 53, pika 3 të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, parashikohet: “*Autoriteti kontraktor, në zbatim të pikës 4 të këtij neni, vlerëson një ofertë të vlefshme, vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentet e tenderit.*”.

III.1.3. Në nenin 27 të Vendimin nr. 914, datë 29.12.2014 të Këshillit të Ministrave “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, parashikohet se:

Autoriteti kontraktor mund t’u kërkojë operatorëve ekonomikë të dorëzojnë dëshmi, që tregojnë se ata i plotësojnë kërkesat minimale, të përcaktuara në dokumentet e tenderit, si:

a) mostra të mallit, kur e gjykon se kjo ka rëndësi për vlerësimin e ofertës teknike. Mostrat duhet të trajtohen si informacion konfidencial tregtar dhe duhet të jenë në kontroll të autoritetit kontraktor. Ato i kthehen ofertuesit, me kërkesën e tij, 30 (tridhjetë) ditë pas nënshkrimit të kontratës, me kusht që kontrata në fjalë të mos jetë objekt i shqyrtimit administrativ apo gjyqësor. Në rastin kur procedura e prokurimit anulohet, mostrat i kthehen ofertuesit, me kërkesën e tij, brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga data e marrjes së vendimit përfundimtar të anulimit; dhe/ose

b) dëshminë e origjinalitetit të mostrave, përshkrimin dhe/ose fotografitë apo katalogët teknike; dhe/ose

c) dëshmi për rezultatet e testimeve zyrtare, të lëshuara nga institucione të autorizuar, që vërtetojnë pajtueshmërinë e produkteve me specifikimet teknike.

III.1.4 Autoriteti Kontraktor në përgjigjen që i ka kthyer operatorit ekonomik ankimues në lidhje me kriterin e mësipërm ka shpjeguar se: “*Kriteri 2.3.3 është një kriter shumë i rëndësishëm i vendosur nga njësia e hartimit të dokumenteve të tenderit për të garantuar cilësinë e materialeve dhe seriozitetin e operatorit ekonomik, ne kemi kërkuar katalog shoqërues për materialet, në qoftë se operatori juaj është prodhues i këtyre materialeve atëherë ju mund të depozitoni një katalog të hartuar nga ju në gjuhën shqipe, për artikujt që ju jeni distributor apo të furnizuar nga një subjekt tjetër, në rastin konkret nga një subjekt i huaj, ju duhet të depozitoni katalogun të përkthyer dhe të noterizuar*”.

III.1.5. Referuar sa më sipër, KPP gjykon se autoriteti kontraktor në përgjigjen drejtuar ankimuesit lidhur me kriterin mbi dorëzimin e katalogëve të përkthyer në gjuhën shqipe, në të cilën tregohen dhe të specifikohen qartë mallrat që do të ofrohen, ka sqaruar se përkthimi është i detyrueshëm për operatorët që paraqenin dokumentacion në gjuhë të huaj. Në rast se operatorit ekonomik pjesëmarrës shfaqet në cilësinë e prodhuesit dhe disponon dokumentacion në gjuhën

shqipe do ta paraqesë atë si të tillë pa qenë nevoja e përkthimit në gjuhën shqipe. Në këtë kuptim KPP gjykon se autoriteti kontraktor ka hartuar kriterin në përputhje me dispozitat ligjore dhe kriteri nuk lë vend për konfuzion.

Sa më sipër pretendimi i operatorit ekonomik ankimues nuk qëndron.

III.2. Lidhur me pretendimin e operatorit ekonomik “InfoSofft Office” SHPK për modifikimin e dokumenteve të procedurës së prokurimit me argumentin se:

[...]-Në kriteret e veçanta të kualifikimit është kërkuar:

2.3.4.1 Operatori ekonomik në ditën dhe orën e hapjes së procedurës duhet të paraqitet pranë autoritetit kontraktor me nga një mostër për çdo artikull të kërkuar në preventiv.

Ne e kuptojmë shumë mirë arsyen pse AK vendos kërkesë për paraqitje mostrash por ndërkohë

“Kërkesa për dorëzimin e mostrave për secilin artikull, është një kërkesë e ekzagjeruar dhe shkon përtej asaj së çfarë është e nevojshme për realizimin e synimit. Komisioni gjykon se, është e mjaftueshme që operatorët ekonomikë pjesëmarrës të paraqesin vetëm nga një ekzemplar (mastër) për produktet që do të prokurohen, me përdorueshmëri më të lartë për institucionin, me qëllim verifikimin nëse këto produkte plotësojnë kërkesat dhe specifikimet teknike të përcaktuara në dokumentet e tenderit.”

Lutemi të hiqet kërkesa për mostra në zbatim të nenit 46 të LPP ku thuhet se kërkesat duhet të jenë në përpjesëtim me natyrën dhe përmasat e kontratës, ose së paku të kërkohen mostra vetëm për artikujt me përdorim më të madh dhe për tonerat e kërkuar sete të pranohet të paraqesim si mostër vetëm njërin nga tonerat e setit, pasi të gjithë tonerat e një seti janë njëlloj, ndryshojnë vetëm nga ngjyra. Duke kërkuar mostra për të gjithë artikujt, edhe për ato që AK do ti blejë në një sasi fare të vogël, ngarkohen OE me shpenzime ekonomike të panevojshme, pasi detyrohen të blejnë të gjitha mostrat (të cilat pavarësisht nga fituesi, sipas detyrimit ligjor, bllokohen për një kohë të gjatë në institucion).[...]., Komisioni i Prokurimit Publik vëren se,

III.2.1. Në pikën 2.3.4.1 “Kapaciteti teknik” të dokumenteve të tenderit të procedurës së prokurimit objekt shqyrtimi, autoriteti kontraktor ka kërkuar si më poshtë vijon:

“2.3.4.1 Operatori ekonomik në ditën dhe orën e hapjes së procedurës duhet të paraqitet pranë autoritetit kontraktor me nga një mostër për çdo artikull të kërkuar në preventiv”.

III.2.2 Në shtojcën 10 “Sasia dhe Grafiku i Lëvrimit” të dokumenteve të procedurës së prokurimit objekt ankimi përcaktohet kriteri si më poshtë:

Sasia dhe grafiku i lëvrimit



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA HIMARË

Nr. 928 prot.

Himarë, më 11.03 .2021

MIRATOHET

KRYETARI I BASHKISË

Jorgo Goro



LENDA: PREVENTIV SHPENZIME KANCELARIE

No	Përshkrimi i produktit	Njësia	Sasia	Cmimi (Lekë)	Vlera (Lekë)
1	Dosje me mekanizem A4 plast 7cm (me pjesen anesore per shenime)	cope	250		
2	Dosje me llastike A4	cope	1000		
3	Dosje te thjeshta kartoni(dosje te bardha kartoni)	cope	1500		
4	Dosje kuti me llastik	cope	200		
5	Dosje arkive boxy 100 kartoni	cope	50		
6	Leter A4	kuti	150		
7	Leter A3	kuti	50		
8	Makinellogaritese te madhe	cope	5		
9	Ndarese dokumentesh	cope	10		
10	Makine kapsesh aktesh te vogla	cope	10		
11	Zarfa 11cmx23cm me Dritare Djathtas	cope	1500		
12	Zarfa A4 23cmx33cm - 110 gr	cope	1500		
13	Zarfa A3 34cmx42cm	cope	1500		
14	Flete hyrje magazine, bllaqe	cope	5		
15	Flete dalje magazine, bllaqe	cope	5		
16	Stilolapsa blu te thjeshte.	cope	100		
17	Lapsa	cope	25		
18	Vizore	cope	10		

Spile, Himarë, tel.: 0393 22355, fax.: 0393 22533, www.himara.gov.al, e-mail: bashkiahimarë@yahoo.com

	Zbardhues	cope	20		
	Bilok stik	cope	100		
21	Kapese delta	cope	100		
22	Qeska aktes	pako	50		
23	Ush, 8GB	cope	10		
24	Bojtuesh (vijues) ngjyra te ndryshme	cope	20		
25	Biloge te vegjelme 3kopje (Urdher-Veprimi)	cope	50		
26	Axhenda	cope	50		
27	Hapse vrimash - e vogel	cope	20		
28	Hapse vrimash - e madhe	cope	25		
29	Kapse akt. me veshe 32mm	cope	25		
30	Kapse akt. me veshe 51mm	cope	25		
31	Tela per makinakapse 24/6	cope	100		
32	Neon indikator Tags	cope	50		
33	Kapese me veshe, te medha, mesatare, te vogla	cope	500		
34	Gershere Zyre - te vogla 18cm	cope	10		
35	Mprehese lapsi	cope	10		
36	Boje vule tampon	cope	20		
37	Shishe boje vule	cope	10		
38	Makine heqese teli te vogel	cope	10		
39	Marker per CD	cope	20		
40	Zarfa per CD	cope	300		
41	CD-R verbatim	cope	250		
42	Lastik gome 200 gr	cope	20		
43	Mbajtese Dokumentash Plastike - pa ngjyre - transparente	cope	300		
44	Mbajtes I karteles dhe ID me lidhese	cope	40		
45	Mbajtes I karteles dhe ID	cope	50		
46	Stilolapsa blu, I zi , verdhe, hiri etj	cope	50		
47	Axhende ditore Viti 2021 me stilolaps	cope	40		
II	TONERAT				
1	Lexermark CS310dn (4ngjyra)	cope	2		
2	Xeron Phaser 3020	cope	6		
3	HP Laserjet 2015	cope	6		
4	HP Laserjet 1536 dnf MFP	cope	6		
5	HP Color Laserjet CP5220 PCL6 (4 ngjyra)	cope	3		
6	HP Laserjet Pro MFP M127fw	cope	12		
7	Lexmark MS312dn	cope	2		
8	HP Laserjet 1020	cope	4		
9	Samsung ML-2160	cope	7		
10	HP Color Laserjet CP5225 (4 ngjyra)	cope	8		

	Lexmark Color CS 410dn (4ngjyra)	cope	4		
	Toshiba e-studio382P	cope	4		
	Kyocera Taskalfa 2200	cope	2		
13	Kyocera FS-6525 MFP	cope	10		
14	HP Officet 7612	cope	2		
15	HP Officet 6700 Premium	cope	2		
16	HP Color Laserjet 3800dn (4ngjyra)	cope	3		
17	Samsung Xpres M2675F	cope	3		
18	Lexmark M317dn	cope	7		
19	Samsung ML-1640	cope	3		
20	Hp officejet K7100	cope	3		
21	Samsung ML- 2010p	cope	3		
22	Lexmark E120	cope	3		
23	Lexmark MS312	cope	3		
24	XeronX 3225 Worlcenter	cope	3		
25	C3330i (4 ngjyra)	cope	2		
26	SHUMA	LEKE			
	TVSH (20%)	LEKE			
	SHUMA TOTALE	LEKE			

Afatet e lëvrim: 30 DITË.

III.2.3. Në nenin 46, pika 1, gërma “b”, të ligjit nr.9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, parashikohet shprehimisht: “Operatorët ekonomikë, për të marrë pjesë në procedurat e prokurimit, duhet të kualifikohen, pasi të kenë përmbushur të gjitha kriteret që autoriteti kontraktor i vlerëson të nevojshme, për sa kohë që ato janë në përpjesëtim me natyrën dhe përmasat e kontratës që do të prokurohen dhe jodiskriminuese. b) aftësia teknike: operatorët ekonomikë vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, për të zbatuar kontratën, siç është përshkruar nga autoriteti kontraktor në njoftimin e objektit të kontratës;

Ndërsa në nenin 53, pika 3 të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, parashikohet: *“Autoriteti kontraktor, në zbatim të pikës 4 të këtij neni, vlerëson një ofertë të vlefshme, vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentet e tenderit”*.

III.2.4. Në nenin 27, pika 6, e VKM nr.914 datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, parashikohet se: *“Autoriteti kontraktor mund t’u kërkojë operatorëve ekonomikë të dorëzojnë dëshmi, që tregojnë se ata i plotësojnë kërkesat minimale, të përcaktuara në dokumentet e tenderit, si:*

a) mostra të mallit, kur e gjykon se kjo ka rëndësi për vlerësimin e ofertës teknike. Mostrat duhet të trajtohen si informacion konfidencial tregtar dhe duhet të jenë në kontroll të autoritetit kontraktor. Ato i kthehen ofertuesit, me kërkesën e tij, 30 (tridhjetë) ditë pas nënshkrimit të kontratës, me kusht që kontrata në fjalë të mos jetë objekt i shqyrtimit administrativ apo gjyqësor. Në rastin kur procedura e prokurimit anulohet, mostrat i kthehen ofertuesit, me kërkesën e tij, brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga data e marrjes së vendimit përfundimtar të anulimit dhe/ose

b) dëshminë e origjinalitetit të mostrave, përshkrimin dhe/ose fotografitë apo katalogët teknike; dhe/ose

c) dëshmi për rezultatet e testimeve zyrtare, të lëshuara nga institucione të autorizuar, që vërtetojnë pajtueshmërinë e produkteve me specifikimet teknike.

III.2.5 Komisioni gjykon se kriteret për kualifikim vendosen që t’i shërbejnë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatorëve ekonomikë, të cilët, nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, gjithçka në funksion realizimit me sukses të kontratës. Në varësi të kontratës dhe volumit të saj autoriteti kontraktor përcakton kërkesat e veçanta për kualifikim, të cilat janë të detyrueshme për t’u përmbushur nga operatorët ekonomikë pjesëmarrës në procedurat e prokurimit.

III.2.6. Në lidhje me kundërshtimet e mësipërme të operatorit ekonomik ankimues, mbi modifikimin e kriterëve të veçanta të kualifikimit, për procedurën e prokurimit objekt ankimi, Komisioni i Prokurimit Publik gjykon se është me vend të ndalet në faktin, nëse kriteri i mësipërm është në proporcion me natyrën dhe përmasat e kontratës që do të prokurohet në zbatim të nenit 46 pika 1 të LPP-së. Në rastin konkret K.P.P. konstaton se synimi bazë i autoritetit kontraktor është vërtetimi se subjektet ofertues zotërojnë kapacitetet e nevojshme për realizimin e kontratës. KPP konstaton se për përmbushjen e këtij synimi, autoriteti kontraktor ka parashikuar në dokumentet e procedurës së prokurimit jo vetëm kriterë kualifikimi të cilat lidhen me vërtetimin e kapacitetit teknik, por edhe kriterë të tjera kualifikimi të cilat lidhen me vërtetimin e plotësisimit të specifikimeve teknike të produktit me anë të dorëzimit të mostrave. Në

këto kushte, KPP gjykon se kërkesa e mësipërme e autoritetit kontraktor mbi dorëzimin e mostrave është në përputhje me nenin 27 pika 6 gërma “a” të Vendimit nr.914 datë 29.12.2014 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, por kërkesa për dorëzimin e mostrave për secilin artikull, është një kërkesë e ekzagjeruar dhe shkon përtej asaj se çfarë është e nevojshme për realizimin e synimit. Komisioni gjykon, se është e mjaftueshme që operatorët ekonomikë pjesëmarrës të paraqesin vetëm nga një ekzemplar (mostër) për produktet që do të prokurohen, me përdorueshmëri më të lartë për institucionin, me qëllim verifikimin nëse këto produkte plotësojnë kërkesat dhe specifikimet teknike të përcaktuara në dokumentet e tenderit. Për këtë arsye, autoriteti kontraktor duhet të bëjë modifikimin e kriterit të sipërcituar sipas konstatimit të mësipërm.

Sa më sipër, pretendimi i operatorit ekonomik ankimues qëndron.

III.3. Lidhur me pretendimin e operatorit ekonomik “InfoSofft Office” SHPK për modifikimin e dokumenteve të procedurës së prokurimit me argumentin se:

[...]-Në kriteret e veçanta të kualifikimit është kërkuar:

Për letrën A4 janë vendosur specifikime teknike fikse apo të kufizuara, gjë që na pengon të ofertojmë me letër më cilësore, që ka specifikime teknike më të larta se ato të kërkuarat.

Në një situatë të ngjashme, pikërisht për specifikimet e letrës A4, KPP është shprehur në vendimin 249/2020, se AK duhet të përcaktojë minimumin e specifikimeve duke lejuar ofertim me specifikime më të larta, për të mundësuar pjesëmarrjen e sa më shumë OE:

“Në këto kushte, Komisioni i Prokurimit Publik gjykon se autoriteti kontraktor duhet të modifikojë dokumentet e tenderit për procedurën objekt ankimimi duke hequr markën e letrës “Duble A” dhe për parametrat fikse të përcaktojë minimumin e tyre.

Prandaj, kërkojmë që të vendoset një minimum, psh: lëmueshmëria ≥ 80 , bardhësia $\geq 169\%$, dhe të lejohet ofertimin me cilësi më të mirë [...]., Komisioni i Prokurimit Publik vëren se,

III.3.1. Në pikën 2.3.5 të shtojcës nr.8 “Kapaciteti teknik” të dokumenteve të tenderit të procedurës së prokurimit objekt shqyrtimi, autoriteti kontraktor ka kërkuar si më poshtë vijon:

• **“Letra A4 duhet të jetë cilësore, 80 g/m² me të dhënat si më poshtë:**

• **Specifikimet e letrës:**

a - Cilësi e parë me certifikatë Iso

b - CIE Bardhësi: 169% dhe pa lustër

c - Pështja e një fije 80 gr/m² dhe një rizmë (500 fije x A4)

d - Përmasat të jenë 210 x 297 mm dhe 297 x 420 mm

e - Lëmueshmëria: 80 – 100 ml/min

f - Multifunktionale – për fotokopje, printer, faks.

- *Ambalazhimi: Mbështjellje kundër lagështirës dhe kuti me kapacitet 5 risma*
- *Të qëndrojnë e rrafshët pas printimit apo fotokopjimit*
- *Të mos lëshojë pluhur letre pas printimit apo fotokopjimit*
- *Të jetë e përshtatshme për printim në të dyja anët*
- *Të plotësojë standardet që letra të mbahet për kohë të gjatë në arkivë”.*

III.3.2 Në Ligjin nr. 9643 datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, neni 46, pika 1, gërma “b”, parashikohet si më poshtë: *“Operatorët ekonomikë, për të marrë pjesë në procedurat e prokurimit, duhet të kualifikohen, pasi të kenë përmbushur të gjitha kriteret e mëposhtme, që autoriteti kontraktor i vlerëson të nevojshme, për sa kohë që ato janë në përpjesëtim me natyrën dhe përmasat e kontratës që do të prokurohet dhe jodiskriminuese: aftësia teknike: operatorët ekonomikë vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, për të zbatuar kontratën, siç është përshkruar nga autoriteti kontraktor në njoftimin e objektit të kontratës”.*

III.3.3 Në Ligjin nr. 9643 datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, neni 23, pikat 1, 2 dhe 3 thuhet si më poshtë: *“Specifikimet teknike, që përcaktojnë karakteristikat e mallrave, punëve dhe shërbimeve që do të prokurohen, duhet të përgatiten për të përshkruar sa më saktë dhe në mënyrë të plotë objektin e prokurimit, duke krijuar kushte për konkurrim të paanshëm e të hapur ndërmjet të gjithë kandidatëve e ofertuesve. Kur është e mundur, specifikimet teknike duhet të përcaktohen në mënyrë të tillë që të kuptohen nga personat me aftësi të kufizuara. 2. Specifikimet teknike duhet të mundësojnë trajtim të njëjtë për të gjithë kandidatët dhe ofertuesit dhe të mos shërbejnë si pengesa për konkurrencën e hapur në prokurimin publik. 3. Specifikimet teknike duhet të përshkruajnë qartë kërkesat e autoritetit kontraktor, duke iu referuar: a) standardeve kombëtare, që mbështeten në ato ndërkombëtare miratimeve teknike ndërkombëtare, specifikimeve teknike të përgjithshme, standardeve ndërkombëtare apo sistemeve të tjera teknike të referimit, të përcaktuara nga organet ndërkombëtare të standardizimit. Kur këto nuk ekzistojnë, ato u referohen standardeve kombëtare, miratimeve teknike kombëtare ose specifikimeve teknike kombëtare, që lidhen me projektimin, përlllogaritjen dhe ekzekutimin e punëve apo përdorimin e produkteve; b) kërkesave në terma funksionale, kur një gjë e tillë kërkon t’u referohesh standardeve kombëtare ose ndërkombëtare, si mënyrë që nënkupton pajtueshmëri me kërkesat funksionale; c) të dyja metodave të përcaktuara në shkronjat “a” dhe “b” të pikës 3 të këtij neni për mallra, shërbime apo punë të ndryshme, të përfshira në të njëjtin objekt kontrate. Çdo referencë duhet të shoqërohet nga fjalët “ose ekuivalenti i tij/saj.”*

III.3.4 Në Vendimin e Këshillit të Ministrave nr.914 datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, neni 27, pika 1, thuhet se: *“Specifikimet teknike duhet të përshkruajnë minimumin ose tërësinë e elementeve më të rëndësishme përbërëse, që garantojnë cilësinë e kërkuar, në përputhje me nenin 23 të LPP dhe që i vlerëson mallrat si të pranueshme për funksionet e kërkuara.”*

III.3.5 Komisioni i Prokurimit Publik gjykon se, autoritetet kontraktore, në hartimin e specifikimeve teknike, krahas përshkrimit të saktë të nevojave të këtij të fundit, duhet të kenë në vëmendje faktin se hartimi i specifikimeve teknike duhet bërë në një mënyrë gjithëpërfshirëse duke krijuar kushte për konkurim të paanshëm e të hapur ndërmjet të gjithë kandidatëve e ofertuesve duke përshkruar sa më saktë dhe në mënyrë të plotë karakteristikat e mallrave/shërbimeve/punëve dhe në përputhshmëri me objektin e kontratës. KPP thekson se një ndër parimet kryesore të zhvillimit të procedurës së prokurimit (parashikuar nga neni 2 gërma “b” dhe “c” e LPP-së) janë ato të transparencës dhe trajtimit të barabartë dhe jodiskriminues për të gjithë operatorët ekonomikë, pjesëmarrës në procedurat e prokurimit publik. Specifikimet teknike duhet të ofrojnë akses të barabartë për ofertuesit dhe nuk duhet të kenë efektin e krijimit të pengesave të pajustificuara për hapjen e prokurimit publik ndaj konkurrencës. Në respekt të parimit të mësipërm, specifikimet teknike në asnjë rast nuk duhet të diskriminojnë/përjashtojnë nga konkurimi operatorët ekonomikë ofertues dhe/ose prodhuesit qofshin këta kombëtar apo ndërkombëtar. Në hartimin e specifikimeve teknike autoritetet kontraktore duhet të shmangin çdo formë diskriminimi qoftë ato të dukshme qoftë ato të fshehta të cilat kanë të njëjtin efekt. Në asnjë rast specifikimet teknike nuk duhet të hartohen në mënyrë që të drejtojnë drejt një produkti/mall/shërbim që ofrohen nga një operator i vetëm ekonomik ose nga një prodhues i vetëm. Në hartimin e specifikimeve teknike autoritetet kontraktore duhet të mbajnë në vëmendje faktin se specifikimet teknike duhet të përshkruajnë minimumin ose tërësinë e elementeve më të rëndësishme përbërëse, që garantojnë cilësinë e kërkuar, në përputhje me nenin 23 të LPP dhe që i vlerëson mallrat si të pranueshme për funksionet e kërkuara, parashikuar edhe nga neni 27, pika 1 e VKM nr.914 datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar. Gjithashtu duke u ndalur në pikën 3 të nenit 23 të LPP-së, KPP gjykon se ligjvënësi ka parashikuar tre metoda kryesore në hartimin e specifikimeve teknike. Konkretisht metoda e parë ka të bëjë me referimin e standardeve kombëtare, që mbështeten në ato ndërkombëtare, miratimeve teknike ndërkombëtare, specifikimeve teknike të përgjithshme, standardeve ndërkombëtare apo sistemeve të tjera teknike të referimit, të përcaktuara nga organet ndërkombëtare të standardizimit. Kur këto nuk ekzistojnë, ato u referohen standardeve kombëtare, miratimeve teknike kombëtare ose specifikimeve teknike kombëtare, që lidhen me projektimin, përlllogaritjen dhe ekzekutimin e punëve apo përdorimin e produkteve. Metoda e dytë ka të bëjë me referimin e kërkesave në terma funksionale, kur një gjë e tillë kërkon t’u referohesh standardeve kombëtare ose ndërkombëtare, si mënyrë që nënkupton pajtueshmëri me kërkesat funksionale. Gjithashtu edhe metoda e tretë e cila është një ndërthurje e dy metodave të mësipërme, por çdo referencë duhet të shoqërohet nga fjalët “ose ekuivalenti i tij/saj”. Autoritetet kontraktore janë të detyruara të zbatojnë me përpikmëri dispozitën e mësipërme të LPP-së në hartimin e specifikimeve teknike dhe kjo duhet pasqyruar edhe në dokumentet e tenderit. KPP gjykon se nga interpretimi teleologjik arrijmë në përfundim se e rëndësishme është që përmes specifikimeve teknike autoriteti kontraktor të mundësojë një konkurim të drejtë, të hapur dhe gjithëpërfshirës, të barabartë dhe jo diskriminuese për të gjithë operatorët ekonomikë si edhe të

mos drejtohen drejt një produkti të vetëm të ofruar nga një operator i vetëm ose nga një numër i kufizuar operatorësh ekonomikë.

III.3.6 Referuar pretendimit të ankimuesit si dhe verifikimeve të kryera për specifikimet e parametrave të përcaktuar në dokumentet e tenderit për produktin letër A4, bazuar në ligjin dhe rregullat e prokurimit publik, është në të drejtën e autoritetit kontraktor të përcaktojë kriteret për kualifikim, gjithnjë kur ato janë të nevojshme dhe të lidhura ngushtë me objektin e prokurimit, bazuar në legjislacionin për prokurimin publik duke mos i tejkaluar kufijtë maksimalë të përcaktuar në këtë të fundit, në funksion të qëllimit dhe parimeve të ligjit për prokurimin publik. Në rastin konkret, Komisioni i Prokurimit Publik gjykon, se për specifikimet e letrës A4 të përshkruajnë minimumin e elementeve më të rëndësishme përbërëse, që garantojnë cilësinë e kërkuar, në mënyrë që këto të fundit të mos jenë kufizuese dhe përcaktuese drejt një prodhuesi të caktuar, me qëllim shmangien e parametrave përcaktuese të detajuara, të cilët kufizojnë pjesëmarrjen e shoqërive në procedurë. Sa më sipër, KPP gjykon se pretendimet e ankimuesit janë të drejta pasi autoriteti kontraktor në hartimin e specifikimeve teknike duhet të evitojë përcaktimet fikse sikundër në rastin konkret pasi përmasat dhe të dhënat fikse çënojnë konkurrencën dhe janë diskriminuese për operatorët ekonomikë pjesëmarrës. Në këto kushte, Komisioni i Prokurimit Publik gjykon se autoriteti kontraktor duhet të modifikojë dokumentet e tenderit për procedurën objekt ankimi, konkretisht për parametrat fikse, të përcaktojë minimumin e tyre, në mënyrë që të mos ketë asnjë element që çon në kufizimin e konkurrencës ndërmjet operatorëve ekonomikë.

Sa më sipër pretendimi i ankimuesit qëndron.

III.4 Lidhur me pretendimin e operatorit ekonomik “InfoSofft Office” SHPK për modifikimin e dokumenteve të procedurës së prokurimit me argumentin se:

[...]-Në specifikimet teknike është kërkuar:

Tonerat duhet të jenë origjinale, bashkëlidhur, me pullë sigurie të firmës prodhuese dhe me numrin serial të njëjtë të stampuar në paketim. Shprehja "për tonerat që prodhohen nga prodhuesi" nuk ka asnjë kuptim, nuk e dimë çfarë ka dashur të thotë AK. Çdo toner, çdo produkt, çfarëdo që të jetë, sido që të jetë, prodhohet nga një prodhues. Çështja qëndron që jo të gjithë prodhuesit aplikojnë vendosjen e numrit serial, dhe ka të tjerë që e aplikojnë vetëm në kuti por jo në toner. Në këto raste ne nuk mund ti detyrojmë prodhuesit të vendosin numër serial sipas kërkesës së AK (edhe në toner, edhe në paketim), sepse nuk kemi kompetenca dhe as mundësi të ndikojmë tek prodhuesit. Ata e përcaktojnë vetë se si i realizojnë produktet e tyre. Pullat e sigurisë të vendosura mbi paketime, janë një zgjedhje dhe një e drejtë që e ka vetëm prodhuesi. Ne si tregtues të tonerave nuk mund të detyrojmë prodhuesit të vendosin pulla në ambalazhet e tyre. Prandaj kjo kërkesë del jashtë kompetencave tona, vendosja e pullave nëpër ambalazhe nuk është në dorën tonë. AK nuk mund të vendosi një kërkesë apo të na vlerësojë për diçka që nuk është as kompetencë, as e drejtë e jona si OE. Komisioni i Prokurimit Publik në vendimin 325/2020, arsyeton se AK nuk mund të hartojë të tilla kërkesa "pasi plotësimi i kërkesës së

mësipërme nuk varet nga vullneti i operatorëve ekonomikë pjesëmarrës për hartimin dhe dorëzimin e ofertave teknike": Komisioni i Prokurimit Publik gjykon se kërkesa e mësipërme nuk është e përshtatshme për arritjen e synimit të autoritetit kontraktor, për verifikimin e përpuethshmërisë së produkteve, kjo pasi plotësimi i kërkesës së mësipërme nuk varet nga vullneti i operatorëve ekonomikë pjesëmarrës për hartimin dhe dorëzimin e oferteve teknike në përputhje me kërkesën e autoritetit kontraktor. Komisioni i Prokurimit Publik gjykon se kërkesa e mësipërme e autoritetit kontraktor nuk është proporcionale me objektin e procedurës së prokurimit, natyrën, përmasat e kontratës si edhe me qëllimin e kërkuar nga vetë autoriteti kontraktor.

Gjykuar sa më sipër, lutemi të shtohet:

Tonerat duhet të jenë origjinale, bashkëlidhur, me pullë sigurie të firmës prodhuese (për rastet kur aplikohet nga prodhuesi) dhe me numrin serial të njëjtë të stampuar në paketim (për rastet kur aplikohet nga prodhuesi). [...], Komisioni i Prokurimit Publik vëren se,

III.4.1 Në pikën 2 të shtojcës nr.9 “Specifikime teknike” të dokumenteve të tenderit të procedurës së prokurimit objekt shqyrtimi, autoriteti kontraktor ka kërkuar si më poshtë vijon:

“Tonerët duhet të jenë origjinale, bashkëlidhur, me pullë sigurie të firmës prodhuese dhe me numrin serial të njëjtë të stampuar në paketim”.

III.4.2 Në nenin 23 pika 1, 2, “Specifikimet teknike” të Ligjit nr.9643 datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik” i ndryshuar parashikohet se:

1. Specifikimet teknike, që përcaktojnë karakteristikat e mallrave, punëve dhe shërbimeve që do të prokurohen, duhet të përgatiten për të përshkruar sa më saktë dhe në mënyrë të plotë objektin e prokurimit, duke krijuar kushte për konkurrim të paanshëm e të hapur ndërmjet të gjithë kandidatëve e ofertuesve. Kur është e mundur, specifikimet teknike duhet të përcaktohen në mënyrë të tillë që të kuptohen nga personat me aftësi të kufizuara.

2. Specifikimet teknike duhet të mundësojnë trajtim të njëjtë për të gjithë kandidatët dhe ofertuesit dhe të mos shërbejnë si pengesa për konkurrencën e hapur në prokurimin publik.

III.4.3. Në nenin 46, pika 1 gërma “b” i ligjit nr.9643 dt.20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar parashikohet se: “[...] 1. Operatorët ekonomikë, për të marrë pjesë në procedurat e prokurimit, duhet të kualifikohen, pasi të kenë përmbushur të gjitha kriteret e mëposhtme, që autoriteti kontraktor i vlerëson të nevojshme, për sa kohë që ato janë në përpjesëtim me natyrën dhe përmasat e kontratës që do të prokurohet dhe jodiskriminuese: b) aftësia teknike: operatorët ekonomikë vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, për të zbatuar kontratën, siç është përshkruar nga autoriteti kontraktor në njoftimin e objektit të kontratës; [...]”

III.4.4. Në nenin 27 “Kontratat e mallrave”, pika 1 dhe 6 të VKM nr.914 datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, parashikohet shprehimisht se:

1. *“Specifikimet teknike duhet të përshkruajnë minimumin ose tërësinë e elementeve më të rëndësishme përbërëse, që garantojnë cilësinë e kërkuar, në përputhje me nenin 23 të LPP dhe që i vlerëson mallrat si të pranueshme për funksionet e kërkuara.*

6. *Autoriteti kontraktor mund t’u kërkojë operatorëve ekonomikë të dorëzojnë dëshmi, që tregojnë se ata i plotësojnë kërkesat minimale, të përcaktuara në dokumentet e tenderit, si:*

a) *mostra të mallit, kur e gjykon se kjo ka rëndësi për vlerësimin e ofertës teknike. Mostrat duhet të trajtohen si informacion konfidencial tregtar dhe duhet të jenë në kontroll të autoritetit kontraktor. Ato i kthehen ofertuesit, me kërkesën e tij, 30 (tridhjetë) ditë pas nënshkrimit të kontratës, me kusht që kontrata në fjalë të mos jetë objekt i shqyrtimit administrativ apo gjyqësor. Në rastin kur procedura e prokurimit anulohet, mostrat i kthehen ofertuesit, me kërkesën e tij, brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga data e marrjes së vendimit përfundimtar të anulimit; dhe/ose*

b) *dëshminë e origjinalitetit të mostrave, përshkrimin dhe/ose fotografitë apo katalogët teknike; dhe/ose*

c) *dëshmi për rezultatet e testeve zyrtare, të lëshuara nga institucione të autorizuar, që vërtetojnë pajtueshmërinë e produkteve me specifikimet teknike.”.*

III.4.5 Referuar kthim përgjigjes së autoritetit kontraktor drejtuar ankimuesit lidhur me kriterin sa më sipër sqarohet se: *“Në lidhje me kundërshtimin tuaj ku ne kemi kërkuar që “tonerat duhet të jenë origjinale, bashkëlidhur me pullë sigurie të firmës prodhuese dhe me numrin serial të njëjtë të stampuar në paketim’ ky kriter është shumë i rëndësishëm pasi është një element sigurie që lidh ambalazhin me tonerin brenda, e bën më të vështirë për tu falsifikuar apo tjetërsuar. Ju thoni që ky kriter të kërkohe vetëm nga prodhuesi dhe ne këtë kemi kërkuar për tonerat që prodhohen nga prodhuesi”.*

III.4.6. Referuar nenit 27 pika 6, gërma “b” të VKM 914/2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, të ndryshuar, me anë të kërkesës së mësipërme, qëllimi i autoritetit kontraktor lidhet drejtpërdrejtë me dorëzimin nga ana e operatorëve ekonomikë të dokumentacionit provues (katalogët/ skedat teknike/ apo skicat e prodhuesit/prodhuesve) në të cilat të jenë lehtësisht të verifikueshme të dhënat teknike të produkteve të ofruara mbi përputhshmërinë e tyre me kërkesat e autoritetit kontraktor. Në kriterin kualifikues të sipërpërmendur dhe të përcaktuar nga autoriteti kontraktor lidhur me kërkesën për tonera origjinale, bashkëlidhur, me pullë sigurie të firmës prodhuese dhe me numrin serial të njëjtë të stampuar në paketim, nuk është e përshtatshme për arritjen e synimit të autoritetit kontraktor, për verifikimin e përputhshmërisë së produkteve, kjo pasi plotësimi i kërkesës së mësipërme nuk varet nga vullneti i operatorëve ekonomikë pjesëmarrës për hartimin dhe dorëzimin e ofertave teknike në përputhje me kërkesën e autoritetit kontraktor. Në këtë rast, Komisioni gjykon se,

autoriteti kontraktor duhet të modifikojë kriterin me qëllim që të përcaktojë se kërkesa e tij për pullë sigurie dhe numër serial i takon vetëm paketimit të tonerit dhe jo domosdoshmërisht toneri brenda ambalazhit duhet të ketë gjithashtu numër serial, në varësi të prodhuesit. K.P.P. gjykon, se autoriteti kontraktor duhet të modifikojë dokumentet e procedurës së prokurimit në përputhje me konstatimet e mësipërme.

Sa më sipër pretendimi i ankimuesit qëndron.

III.5 Lidhur me pretendimin e operatorit ekonomik “InfoSofft Office” SHPK për modifikimin e dokumenteve të procedurës së prokurimit me argumentin se:

[] -Lidhur me specifikimet teknike, pasi na u sqaruan disa pika nga AK, ende mbeten të paqarta disa të tjera. Bazuar në nenin 23, lutemi na sqaroni:

Nr	Përshkrimi	Specifikime teknike	Njësia	Sasia	Kërkesë për sqarim
5	HP Color Laserjet CP 5225 PCL6 (4 ngjyra)		copë	3	Kërkoni tre sete secila me nga 4 ngjyra? Pra 12 copë në total?
10	HP Color Laserjet CP 5225 (4 ngjyra)		copë	8	Për këtë artikull kërkoni 8 sete me nga 4 ngjyra apo vetëm 8 copë bojëra?
11	Lexmark Color CS 410 dn (4 ngjyra)		copë	4	Për këtë artikull kërkoni 4 sete me nga 4 ngjyra apo vetëm 4 copë bojëra?
17	HP Color Laserjet 3800 dn (4 ngjyra)		copë	3	Për këtë artikull kërkoni 3 sete me nga 3 ngjyra apo vetëm 3 copë bojëra?

19			copë	7	Na jepni modelin e plotë të pajisjes pasi Lexmark M317dn nuk është i plotë. Ekzistojnë modele MS 317, MX 317, CS 317, CX 317.
26	C3330i (4 ngjyra)		copë	2	Për këtë artikull kërkoni 4 sete me nga 4 ngjyra apo vetëm 4 copë bojëra.

III.5.1. Referuar kthim përgjigjes së autoritetit kontraktor drejtuar ankimuesit lidhur me specifikimet sa më sipër sqarohet se: *“Në lidhje me specifikimet teknike ju jeni të paqartë në lidhje me termin “Kuti” po ju sqarojmë se me termin kuti ne kemi parasysh paketimin standard që përbëhet nga 5 risma. Në lidhje me paqartësinë tuaj për tonerat Lexmark CS310dn (4 ngjyra)x 2 copë, po ju sqarojmë se kërkojmë sete me nga katër ngjyra secila dhe në të gjitha rastet është kërkuar set me nga katër ngjyra. Në lidhje me zërin 5 ku kërkohet toner HP Color Laser Jet CP 5220 PCL6 (4 ngjyra) është e njëjta gjë me HP Color Laser Jet CP 5225.”*

III.5.2 Lidhur me pretendimet sa më sipër të ankimuesit të parashtruara në formën e pyetjeve lidhur me specifikimet teknike të mallrave, KPP gjykon se autoriteti kontraktor nuk ka sqaruar ankimuesin mbi të gjitha pretendimet e ngritura. Në këtë kuptim KPP gjykon se autoriteti kontraktor si organi përgjegjës për hartimin e kriterëve kualifikuese dhe justifikimin për vendosjen e tyre , duhet të sqarojë ankimuesin në mënyrë shteruese mbi të gjitha pyetjet e ngritura, si edhe të bëjë publikimin e sqarimit përkatës në sistemin e prokurimeve elektronike në përputhje me nenin 42 të LPP, i cili, parashikon shprehimisht se: *“Ofertuesi i mundshëm mund të kërkojë sqarime për dokumentet e tenderit nga autoriteti kontraktor, i cili duhet t’i përgjigjet çdo kërkesë për sqarim të dokumenteve të tenderit, të bërë nga çdo operator ekonomik, me kusht që kërkesa të jetë marrë jo më vonë se 5 ditë para afatit përfundimtar të dorëzimit të ofertave. Autoriteti kontraktor duhet të përgjigjet brenda 3 ditëve nga depozitimi i kërkesës, në mënyrë që të bëjë të mundur dorëzimin e ofertës në kohë nga operatori ekonomik dhe, pa identifikuar*

burimin e kërkesës, duhet t'ia komunikojë sqarimin përkatës të gjithë operatorëve ekonomikë, që kanë tërhequr dokumentet e tenderit [...]”, me qëllim njohjen e të gjithë operatorëve ekonomikë ankimues me sqarimet për dokumentet e tenderit, për të qenë të qarta e të saktë për të gjithë të interesuarit për këtë procedurë prokurimi.

Sa më sipër pretendimet e ankimuesit qëndrojnë.

Për sa më sipër, në mbështetje të nenit 19/1 dhe vijues, të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, nenit 31 të Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 596/2018, datë 12.09.2018 “Për miratimin e rregullave “Për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, Neni 4, i Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 500/2020 datë 5.11.2020 “Rregullore për Marrjen e Masave Organizative për Ushtrimin e Veprimtarisë së Institucionit të Komisionit të Prokurimit Publik gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID -19”, Komisioni i Prokurimit Publik, njëzëri,

Vendos

1. Të pranojë pjesërisht ankesën e paraqitur nga operatori ekonomik “InfoSofft Office” SHPK për procedurën e prokurimit “Kërkesë për Propozime”, Nr. REF-91332-03-26-2021, me objekt “Blerje Kancelarie” me fond limit 1,666,633 (një milionë e gjashtëqind e gjashtëdhjetë e gjashtë mijë e gjashtëqind e tridhjetë e tre) lekë pa TVSH, parashikuar për tu zhvilluar në datën 09.04.2021 nga autoriteti kontraktor, Bashkia Himarë.
2. Autoriteti kontraktor të kryejë modifikimet përkatëse në dokumentet e tenderit sipas konstatimeve të mësipërme të Komisionit të Prokurimit Publik.
3. Autoriteti kontraktor, brenda 10 ditëve, të vërë në dijeni Komisionin e Prokurimit Publik për zbatimin e këtij vendimi.
4. Ngarkohet zyra e financës që të bëjë kthimin e tarifës financiare të paguar nga operatori ekonomik ankimues “InfoSofft Office” SHPK.
5. Kopje e këtij vendimi i dërgohet për njoftim Agjencisë së Prokurimit Publik.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Nr. 603 Protokoli, Datë 14.04.2021

KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Anëtar	Anëtar	Anëtar
Vilma Zhupaj	Lindita Skeja	Merita Zeqaj

Kryetar
Jonaid Myzyri